



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 6 (827913)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 shkurt 2025

Ministri Vengu: Ringjallim industrinë ushtarake, më shumë vigjilencë për Kosovën



Meetings of NATO Ministers of Defence

13 II 2025

Réunions des ministres de la défense de l'OTAN

» faqe 3



SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: HAPA TË SHPEJTË DREJT MODERNIZIMIT DHE ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral-lejtënant Arben Kingji mori pjesë në konsultimet e përbashkëta me NATO-n, mbi detyrimet dhe angazhimet e FARSH-së në kuadër të mbrojtjes kolektive, ku dhe u takua me...



» faqe 3



14 SHKURT 1969, KRIJOHET BATALIONI I VËZHGIMIT AJROR

Forcat Ajrore Shqiptare janë një nga tre armët e Forcave të Armatosura Shqiptare. Forca Ajrore përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i FAJ, Baza Ajrore Farkë, Baza Ajrore Kuçovë, Qendra e Vëzhgimit Ajror, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak...



» faqe 5



TË DUASH NJË USHTARAK DO TË THOTË TË DUASH NJË HERO TË PËRDITSHËM!

Shpeshherë, parë nga larg nën uniformën e gjelbër dhe staturën 'hijerëndë' që iu jep madhështia e saj, na krijojnë përshtypjen e njerëzve të hekurt. Por ushtarakët janë njerëz si gjithë të tjerët, kanë ndjenja, dashuri dhe lidhje të forta...



» faqe 6-7

Dokumentari “Në besë të shqiptarëve”, Ministri Vengu: Besa, identikiti ynë kombëtar

“Në Besë të Shqiptarëve!”, ishte dokumentari i realizuar mbi historinë e 8 nëntorit të vitit 1943, kur një avion amerikan që po shkonte nga Catania në Bari, në bordin e të cilit ndodheshin mjekë dhe infermierë, bie në liqenin e Belshit, Elbasan.

Ngjarja mbeti në harresë për pesë dekada. Janë dhjetëra histori përgjatë gjithë dokumentarit që tregojnë se shqiptarët i dhanë besën amerikanëve dhe ia dolën t’i shpëtojnë të gjallë.

Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane e kanë këtë histori si një gur të çmuar aleance dhe bese.

Kjo ngjarje e rëndësishme mbledhi në Muzeun e Forcave të Armatosura, ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Pirro Vengu, historianë, studiues, studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura, oficerë në rezervë dhe ish-ushtarakë.

Ministri i Mbrojtjes Vengu u shpreh se: “Ky dokumentar na kthen pas në kohë, duke kujtuar aktin e jashtëzakonshëm të humanizmit dhe guximit të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai shprehu gjithashtu se besa është një nga vlerat më të çmuara të identitetit kombëtar shqiptar, e cila është e rrënjësuar thellë në traditën dhe kulturën tonë, si një udhërrëfyes moral dhe shoqëror. ‘Në besë të shqiptarit’ na bëri sërish bashkë, këtë herë në shtëpinë tonë, me ish-ushtarakë dhe të rinj që e shohin të ardhmen e tyre në Forcat e Armatosura”.

Momente që na kthejnë pas në kohë dhe rikujtojnë aktin e jashtëzakonshëm të humanizmit dhe guximit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Një histori që na jep mundësinë të reflektojmë mbi një nga vlerat më të çmuara të identitetit tonë kombëtar: Besën, e cila mbetet e rrënjësuar thellë në traditën dhe kulturën tonë, si një udhërrëfyes moral dhe shoqëror”, - do të shprehej në fund të këtij aktiviteti ministri i Mbrojtjes Vengu.



Guardia di Finanza dhuron dy anije, Ministri i Mbrojtjes Vengu: Forcim i sigurisë kufitare dhe luftës kundër trafikëve

Dy anije të klasit “Vedeta 2000”, donacion i Guardia di Finanza dhe misionit Interforza i shtohen shërbimeve të Kufirit Detar. I pranishëm në ceremoninë e dhurimit, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu e cilësoi këtë një moment të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të monitorimit të hapësirave detare të Shqipërisë.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të shkëlqyer dhe mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët italianë: “Dhurimi i dy anijeve të klasit ‘Vedeta 2000’ nga Guardia di Finanza dhe Misioni Interforza është një dëshmi padyshim e bashkëpunimit të shkëlqyer dhe mbështetjes së vazhdueshme që marrim nga partnerët tanë italianë, në funksion të rritjes së kapaciteteve të forcave tona të policisë dhe Forcave tona të Armatosura. Ç’ është e vërteta, që prej korrikut të vitit të kaluar, nën drejtimin e dy kryeministrave, kryeministrit Rama dhe kryeministres Meloni, një ekip i përbashkët i përbërë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme së bashku me partnerët tanë në bregun tjetër të Adriatikut, ministrat Salvini dhe Crosetto kemi mundur në fakt



dakordësinë e një protokollit rritjes kapacitetesh për Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura Shqiptare”, - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Ministri Vengu vuri në dukje rolin e rëndësishëm që këto anije do të luajnë në mbrojtjen e kufirit detar dhe sigurinë e shtetasve shqiptarë dhe italianë, si dhe të turistëve që vizitojnë bregdetin shqiptar.

“Ky akt është një vazhdimësi e angazhimit të përbashkët të dy qeverive për forcimin e sigurisë



kufitare dhe luftën kundër trafikëve, pasi këto anije do të luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e kufirit detar dhe sigurinë e shtetasve shqiptarë dhe italianë si dhe të turistëve që vizitojnë bregdetin tonë”, - tha ministri Vengu.

Ministri Vengu falënderoi Guardia di Finanza për mbështetjen e palodhur dhe përpjekjet e vazhdueshme për të rritur sigurinë në rajon si dhe misionin Interforza për Policinë e Shtetit Shqiptar për bashkëpunimin intensiv dhe

përkushtimin që ka mundur realizimin e këtij projekti në një kohë shumë të shpejtë.

Të pranishëm në ceremoninë e dorëzimit të mjeteve ishin edhe ambasadori i Italisë në Shqipëri Marco Alberti, komandanti i Përgjithshëm i Guardia di Finanza, gjenerali Andrea De Gennaro, drejtori i Emigracionit në Policinë Kufitare, prefekti Claudio Galzerano, zëvendësministri i Brendshëm Julian Hodaj dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ilir Proda. Dy anijet e klasit “Vedeta 2000”, janë të lehta, të shpejta dhe funksion kryesor kanë ndjekjen dhe interceptimin e mjeteve lundruese në det, duke ndihmuar kështu për një monitorim e kontroll efikas të hapësirës detare të vendit tonë për mjetet lundruese, në funksion të parandalimit dhe luftës kundër trafikëve dhe kontrabandës që mund të kryhet nëpërmjet hapësirës detare, si dhe rritjes së sigurisë së shtetasve vendas dhe turistëve të huaj që shfrytëzojnë bregdetin shqiptar për të kaluar pushimet.



Ministri Vengu: Ringjallim industrinë ushtarake, më shumë vigjilencë për Kosovën

Ministrat e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s u mbledhën në Bruksel, nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Aleancës Mark Rutte. Kryefjala e këtij samiti ishte rritja e domosdoshme e kontributeve dhe kapaciteteve të vendeve aleate, në dritën e negociatave për një paqe të qëndrueshme mes Rusisë dhe Ukrainës.

Në lidhje me këtë takim, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu shprehet se vendet evropiane duhet të rrisin kapacitetet luftarake dhe marrjen e përgjegjësisë të reja për mbrojtjen e kontinentit, në kuadër të një “impulsi të ri amerikan”.

Ai thotë se Shqipëria do të fokusohet në rritjen e kapaciteteve operacionale, ringjalljen e industrisë ushtarake dhe infrastrukturën e Forcave të Armatosura. Ministri Vengu ka pasur një takim edhe me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, Pete Hegseth. Nën impulsin e ri amerikan, pritshmëritë janë të larta për një përpjekje më të madhe të vendeve evropiane në forcimin e kapaciteteve luftarake dhe marrjen e përgjegjësisë të reja për mbrojtjen e kontinentit. Shqipëria e gatshme për shtimin e burimeve financiare, që do të thotë: më shumë kapacitete operacionale, ringjallje të industrisë ushtarake, infrastrukturë në mbështetje të modernizimit të forcave tona dhe në funksion të Aleancës.

Në këtë kontekst, një industri ushtarake



reaguese është kyçe për të prodhuar armatimin, municionet dhe pajisjet e nevojshme. Gjithashtu, është e domosdoshme nevoja për vigjilencë



të shtuar të Aleancës në Evropën Juglindore, veçanërisht në raport me Kosovën, si dhe në zonën Adriatiko-Joniane, ku planet aleate

meritojnë të përditësohen me veprime të reja strategjike përballë sfidave të shumta hibride me të cilat po përballemi.

SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Hapa të shpejtë drejt modernizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në konsultimet e përbashkëta me NATO-n, mbi detyrimet dhe angazhimet e FARSH-së në kuadër të mbrojtjes kolektive, ku dhe u takua me z. Karl Ford, drejtorin e Planifikimit të Mbrojtjes në Stafin Ndërkombëtar të NATO-s, dhe gjeneral brigade Frederic Gauthier, zëvendëshefi i Shtabit për Planifikimin e Mbrojtjes në Komandën e NATO-s për Transformim.

SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji iu ofroi homologëve të tij një panoramë të zhvillimeve në FARSH, modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, të cilat do të rriten dhe më tej në të ardhmen, në sajë të vullnetit politik për të marrë përsipër paketën e re të objektivave të kapaciteteve.



Baza Ajrore e Kuçovës, pikë kyçe për mbrojtjen dhe sigurinë rajonale

Qeveria Shqiptare është e vendosur të forcojë asetet e Forcave të Armatosura në shërbim të NATO-s, duke e çuar Bazën Ajrore të Kuçovës në një nivel të ri operacional dhe strategjik. Investimet në infrastrukturë, modernizim dhe trajnime po e kthejnë këtë bazë në një pikë kyçe për mbrojtjen dhe sigurinë rajonale:

- Brenda pak javësh, përfundon ndërtimi i infrastrukturës për mirëmbajtjen e dronëve, një kapacitet i ri që rrit ndjeshëm efikasitetin e bazës;

- Rikonstrukcioni i hapësirave stërvitore tashmë është finalizuar, duke garantuar kushte optimale për stafin e angazhuar 24/7 në operacione dhe mirëmbajtje;

- Baza e armatimit dhe furnizimit është tashmë në standarde moderne, duke siguruar mbështetje logjistike të nivelit më të lartë për flotën ajrore.

Ky investim strategjik i Qeverisë Shqiptare është vetëm fillimi. Modernizimi i mëtejshëm i Forcës Ajrore mbetet një prioritet për të ardhmen e sigurisë kombëtare dhe angazhimeve tona në NATO.



Nënkolonel Dhimitër Selmanaj, zyrtarisht komandanti i ri i Policisë Ushtarake

Uprezantua në një ceremoni të veçantë, komandanti i ri i Policisë Ushtarake, nënkolonel Dhimitër Selmanaj. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga shefi i SHP të FARSH-së, gjeneralletjënant Arben Kingji si dhe oficerë, nën-officerë dhe personel civil i Policisë Ushtarake.

Në fjalën e tij, ministri Vengu vuri theksin te roli i Policisë Ushtarake, e cila, përveç detyrave të zakonshme, ka marrë përsipër misionet gjithnjë e më të rëndësishme, përfshirë pjesëmarrjen në misionet jashtë vendit dhe mbështetje për emergjencat civile. Ai e vlerësoi këtë angazhim dhe bashkëpunimin e Policisë Ushtarake me agjencitë tjera ligjzbatuese.

“Ky 33 vjetor na gjen me dy risi, e para, tërësia e garnizonit dhe infrastrukturës vendosen në dispozicion të Policisë Ushtarake, duke mbartur gjithashtu edhe detyrën për komandantin e ri, që t’ju mbështesë së bashku me shtabin e tij dhe së bashku me struktura të tjera të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura për një rehabilitim tërësor të infrastrukturës, ku ju operoni. Elementi i dytë është elementi padyshim i emërimit të komandantit të ri, i cili rikthehet në Policinë Ushtarake, një forcë që shpeshherë është konceptuar si e dedikuar vetëm për mbarrëvajtjen e proceseve ligjzbatuese brenda Forcave të Armatosura, por që shumë e më shumë vitet kanë treguar që ka marrë përsipër misionet edhe më të rëndësishme, përtej përshkrimit klasik të misionit tuaj”, - theksoi ministri Vengu.

Ministri Vengu shprehu besimin se, me komandantin e ri, Policia Ushtarake do të vazhdojë të rrisë profesionalizmin dhe përgatitjen. “Kur them misionet të tjera, e kam fjalën për pjesëmarrjen tuaj në misionet jashtë vendit, e kam fjalën për pjesëmarrjen tuaj në misionet në mbështetje të Emergjencave Civile, ku e di veçanërisht dedikimin tuaj dhe e kam vlerësuar dhe vazhdoj ta vlerësoj maksimalisht, sikundër edhe bashkëpunimin tuaj me agjencitë tjera ligjzbatuese, mision, i cili, besoj unë, duhet të përbëjë një shtyllë edhe më të fortë të profesionalizmit, përgatitjes, investimeve në kapitalin njerëzor, në sisteme, mjeteve dhe pajisje”, - theksoi z. Vengu.

Ministri theksoi gjithashtu se prioriteti i këtij viti është modernizimi dhe investimi i mëtejshëm në mjetet, pajisjet dhe infrastrukturën e Policisë Ushtarake. “Do të doja që këtë vit të 34-të të aktivitetit të



Policisë Ushtarake t’ia dedikonim në fakt modernizimit dhe investimeve të mëtejshme, jo vetëm në komoditet në ambientet e tuaja të punës, jo vetëm në kushte më cilësore, ku operoni, por gjithashtu edhe në mjete dhe pajisje që janë, jo vetëm të dobishme, por duhet të zhdërvjelltësojnë edhe mënyrën se si operoni”.

Ministri tha se së bashku me shefin e Shtabit dhe komandantin e ri do të bëjnë një përmirësim cilësor, të të gjithë kuadrit operator dhe ligjor, me të cilin operon Policia Ushtarake.

Për më tepër, ministri Vengu njoftoi një rritje të trajtimit financiar për të gjitha kategoritë e personelit të Policisë Ushtarake dhe theksoi se rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të gjitha strukturave dhe mjeteve do të mbetet një nga prioritetet e Ministrisë së Mbrojtjes. “Ju keni përfaqësuar dhe vazhdoni ta përfaqësoni me dinjitet vendin në disa misionet, në Sinai, Egjipt, Kosovë dhe detin Egje dhe jeni

nga ato forca që kontribuojnë në rrezatimin e Forcave të Armatosura brenda Aleancës. Përgjegjësia juaj është e madhe, por vjen gjithashtu edhe me besimin dhe angazhim tonë ndaj jush. Ky 33 - vjetor vjen gjithashtu me një rritje të trajtimit financiar për të gjitha kategoritë e personelit të Policisë Ushtarake dhe, nga ana tjetër si e thashë, rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të gjithë infrastrukturës, mjeteve dhe pajisjeve do të jetë shtylla e veprimtarisë sonë në këtë vit”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Në përfundim, ministri Vengu u shpreh se ai beson që komandanti i ri, nënkolonel Dhimitër Selmanaj, do të vazhdojë të forcojë standardet profesionale dhe të mbajë në nivele të larta disiplinën dhe zbatimin e ligjit, duke dëshmuar se Policia Ushtarake është një forcë e besueshme dhe e gatshme për t’u mbështetur nga qytetarët dhe Forcat e Armatosura.



KM, pjesë e stërvitjes shumëkombëshe “Combined Resolve 25-1”

Skuadra EOD e Komandës Mbështetëse vazhdon të përmbushë me sukses një sërë detyrash në kuadër të stërvitjes shumëkombëshe “Combined Resolve 25-1”, e cila po zhvillohet në Gjermani. Çaktivizimi i kurtheve me eksplozivë, eliminimi i municioneve të ndryshme si predha artilerie të vendosura si pjesë e skenarit të stërvitjes nga forcat kundërshtarë, janë disa nga detyrat e realizuara, të cilat kanë ndikuar në përfundimin me sukses të stërvitjes shumëkombëshe që po zhvillohet në këtë vend.

EOD, misioni vazhdon...

Kompania EOD e Batalionit të Xhenios ka kontribuar në pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme të paplasura. Specialistët xhenierë, me profesionalizëm të lartë, kanë asgjësuar dhe larguar municionet e gjetura në bashkitë Delvinë dhe Himarë, duke siguruar mbrojtjen e jetës së banorëve dhe mjedisit përreth.





Forcat Ajrore Shqiptare janë një nga tre armët e Forcave të Armatosura Shqiptare. Forca Ajrore përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i FAJ, Baza Ajrore Farkë, Baza Ajrore Kuçovë, Qendra e Vëzhgimit Ajror, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak dhe Kompania e Mbështetjes e FAJ.

Përpjekjet për krijimin e Armës së Aviacionit janë të hershme. Qeveritë e para Luftës së Dytë Botërore, me gjithë përpjekjet nuk arritën ta realizojnë një gjë të tillë, kryesisht për arsye ekonomike.

Hapi i parë për të krijuar një Aviacion Ushtarak në Shqipëri, u hodh më 1914, kur qeveria shqiptare porositi blerjen e tre avionëve “Lohner Daimler” nga Austria për të formuar Korpusin Ajror Shqiptarë. Si rezultat i Luftës së Parë Botërore, urdhri u anulua dhe gjatë viteve 1920-1930 Shqipëria nuk kishte burimet e nevojshme për të rifilluar zhvillimin e një Force Ajrore. Përpjekjet e para për të blerë aeroplanë dhe për të krijuar një Forcë Ajrore rifilluan përsëri në fundin e viteve ‘30, kohë në të cilën kadetë për pilotë u dërguan për studime në Austri, Itali dhe Francë.

Aviacioni Luftarak Shqiptar është krijuar pas Luftës së Dytë Botërore dhe data zyrtare e krijimit të tij është 24 prilli i vitit 1951. Edhe Vëzhgimi i Hapësirës Ajrore është institucionalizuar pas luftës. Më 14 shkurt të vitit 1947 është krijuar kompania e VAIN-it për vrojtimin e hapësirës ajrore dhe informimin për objektet e zbuluara. Grupimi i parë i avionëve luftarakë është bërë në Tiranë në vitin 1951, ku bënë pjesë avionë PO-2 dhe JAK-18. Reparti i parë i Aviacionit Reaktiv është krijuar në vitin 1955 në Kuçovë dhe kishte në përbërje të tij avionë MIG-15.

Në vitin 1957 krijohet Reparti i Transportit Ushtarak në Tiranë, i cili kishte në përbërjen e tij avionë Po-2, JAK-18 dhe helikopterë MI-1 dhe MI-4.

Në vitin 1962 u krijua Regjimenti i Aviacionit në Rinas, i cili kishte në përbërjen e tij një skuadrilje me avionë MIG-19 dhe një skuadrilje me avionë MIG-17. Po në vitin 1962 krijohet edhe Shkolla e Aviacionit.

Në vitin 1967 krijohet Regjimenti i Helikopterëve, që numëronte në parkun e tij mbi 30 helikopterë të rinj MI-4.

Në vitin 1974 krijohet Regjimenti i Gjadrit, i cili ishte i pajisur me avionë MIG-21 dhe MIG-19, përveç disa avionëve mësimorë MIG-17 e MIG-15 për trenerim.

Në vitet ‘70 Aviacioni Luftarak kishte në efikasitet të plotë mbi 70 avionë MIG-19 dhe 12 avionë MIG-21, një skuadrilje luftarake me MIG-17 dhe shumë avionë luftarakë-mësimorë të tipit MIG-15. Pjesë e parkut ushtarak të avionëve ishin edhe katër avionë transporti IL-14, të cilët shërbenin si avionë për transport qeveritar apo për studime ushtarake e gjeografike.

Në Tiranë, në fushën e Laprakës ishin të dislokuar edhe 12 avionë transporti të lehtë AN-2 që shërbenin për transport trupash dhe në ndihmë të ekonomisë. Në Shkollën e Lartë të Aviacionit në Vlorë, veç avionëve reaktivë MIG-15, kishte gjithashtu edhe dy skuadrilje me avionë me helikë JAK-81, të cilët shërbenin për përgatitjen e pilotëve në vitin e parë të kualifikimit si pilot. Në Regjimentin e Rinasit kishte gjithashtu edhe një avion bombardues të lehtë tip IL-28.

Në vitet ‘70-‘80 niveli i programimit të fluturimeve ishte intensiv dhe sasia e fluturimeve për çdo pilot e avion ishte i standardeve e kërkesave të larta.

Pas viteve 2000, në Forcat Ajrore filloi prurja e teknikës fluturuese Perëndimore.

Në prill të vitit 2001, erdhën helikopterët e parë AB-206, ndërsa më 26 nëntor 2003 është kompletuar një skuadrilje e tillë.

Më 24 prill 2004, erdhi helikopteri i parë AB-205.

Më 1 shkurt të vitit 2007, erdhi helikopteri për transport VIP A - 109.

Më 18 qershor 2007, erdhën helikopterët e parë BO - 105.

Më 28 korrik 2012, erdhi helikopteri EC-145, i versionit VIP.

Më 3 dhjetor 2012, erdhi helikopteri i parë shumëfunksional tip “Cougar”.

Më 25 prill 2013, vjen helikopteri i dytë shumëfunksional tip “Cougar”.

Më 18 dhjetor 2013, vjen helikopteri i tretë shumëfunksional tip “Cougar”.

Më 27 tetor 2014, është futur në përdorim të Forcës Ajrore helikopteri i katërt tip “Cougar”.

Më 31 tetor 2015, hyjnë në përdorim në FA dy helikopterë EC-145.

II. Mbrojtja Kundërajrore dhe Aviacioni janë “takuar e ndarë” disa herë nga forma organizative, por bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashkëputur. Në fillimet e saj, Arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t’u bashkuar përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i parë i Aviacionit ka qenë zoti Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974. Nga viti 1975 e deri në vitin 1995, komandantë të Aviacionit kanë qenë Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj.

Shumë ushtarakë të këtyre armëve, që kanë drejtuar e punuar në vite, janë nga figurat më të shquara të ushtrisë sonë, ku përmendim Rrahman Parllaku, Gjini Marku, Hito Çako, Todi Naço,

14 shkurt 1969, krijohet Batalioni i Vëzhgimit Ajror



Sotir Filto, Arif Hasko, Edip Ohri, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Haki Jupasi, Perlat Binaj, Salih Dibra, Haki Jupasi, Stefan Kagjini, Lulo Musai, Perikli Teta, Foto Lako, Harilla Rebi, Perlat Sula, gjeneral brigade Astrit Jaupi, etj., të cilët kanë qenë të njohur në të gjithë radhët e ushtrisë për kryerjen e detyrave.

III. Mbrojtja Kundërajrore, Aviacioni Luftarak dhe repartet e Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore pavarësisht nga format organizative të ndryshme në vite kanë qenë gjithnjë të lidhura e në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, por edhe me lidhje varësie e strukturore të ndryshme me njëra-tjetrën në vite.

Mbrojtja Kundërajrore e vendit ka si ditë të themelimit të saj 1 korrikun e vitit 1931, datë në të cilën doli akti ligjor “Mbi organizmin e Ushtrisë Kombëtare” dhe u sanksionua vendosja e tri baterive të para kundërajrore në vendin tonë në portet e Shëngjinit, Durrësit e Sarandës. Mbrojtja Kundërajrore pati një zhvillim të madh për kohën në vitet 60-70. Në vitet 1954-1955 ajo u pajis me bateri KA-85mm e mjete radioteknike më të sofistikuara, ndërsa në vitet 1957-1958 u pajis me bateri 57 dhe 100mm. Në vitet 1959-1969, në armatim futen edhe raketat e drejtuara, topat AKA-37mm, topat 57mm dhe 100mm me drejtim automatik, mitralozat 14,5mm me katër tytë, dhe me radarë të zbulimit të largët, të mesëm, të afërt. Regjimenti i Raketave të Drejtuara Kundërajrore, që konsiderohej si krenaria e kësaj arme është krijuar, më 6 dhjetor të vitit 1968. Në vitet ‘70 kishte 22 regjimente të AKA-së, 18 batalione mitraljere AKA, që llogarishnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit.

Qendra e Vëzhgimit Ajror u krijua në gusht të vitit 2010,

si rezultat i implementimit të strukturës së re të Forcës Ajrore. Vend dislokimi i saj është në Rinas.

Qendra e Vëzhgimit Ajror është pasues i Batalionit të Mbrojtjes Ajrore. Siç dihet, në aktin ligjor të datës 1 korrik 1931 “Mbi organizmin e Ushtrisë Kombëtare” u sanksionua vendosja e tre baterive të para kundërajrore në vendin tonë në portet e Shëngjinit, Durrësit e Sarandës, datë e cila është edhe dita e krijimit zyrtar të kësaj arme.

Më 14 nëntor 1947, krijohet regjimenti i parë i Artilerisë Kundërajrore (AKA) në Tiranë, pasi ishte bërë më parë përqendrimi i kësaj njësie në ish-Shkollën e Instruksionit të Artilerisë në Kavajë, ku u grumbulluan topat kundërajrorë 29mm, 37mm dhe 40mm, tre bateri kalibër 76mm dhe një bateri e kalibrit 85mm.

Më 24 maj 1948 regjimenti mori emrin “Ali Demi”. Në gusht të po atij viti efektivat e regjimentit rrëzuan një avion tip “Spitfire”.

Në vitet 1954-1955 regjimenti u pajis me bateri KA-85mm e mjete radioteknike më të sofistikuara, ndërsa në vitet 1957-1958 u pajis me bateri 57mm dhe 100mm.

Në vitet 1959-1969, në armatim futen edhe raketat e drejtuara, topat AKA-37mm, topat 57mm dhe 100mm me drejtim automatik, mitralozat 14,5mm me katër tytë, ndërkohë që MKA u pajis edhe me radarë të zbulimit të largët, të mesëm, të afërt. Nga kjo njësi, pas plotësimit vit pas viti me teknikë luftarake kanë dalë një numër i madh kuadrosh drejtues, por edhe reparte të reja, që janë shtrirë më pas në të gjithë vendin.

Në vitet ‘70 kishte 22 regjimente të AKA, 18 batalione mitraljerë AKA, që llogarishnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit.

Regjimenti i Raketave të Drejtuara Kundërajrore që konsiderohej si krenari e kësaj arme është krijuar, më 6 dhjetor të vitit 1968, pasi kishte bërë një demonstrim të kësaj teknike në paradën ushtarake të vitit 1964.

Figura të shquara ushtarake kanë komanduar Regjimentin e Artilerisë si: Muharrem Shabani, Simo Dharmo, Atif Ruci, Raqi Iftica, Siri Strazimiri, Savo Kavaja, Kiço Janku, Naun Gjiniqasi, Maqo Zoto, Bejto Isufi, Pasho Zhupa, Qendro Mustafaraj, Alush Bisha, Namik Shehu, Ferhat Turhani, Pëllumb Gjondedaj, Metan Ismaili, Vangjel Mati, Xhevdet Ramçaj, Hiqmet Zyberi, Rustem Lami, Arqile Kokëdhima, Mehmet Mehmetaj, Tomorr Mukaj.



Të duash një ushtarak do të thotë të duash një hero të përditshëm!

INTERVISTOI:
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Shpeshherë, parë nga larg nën uniformën e gjelbër dhe staturën ‘hijerëndë’ që iu jep madhështia e saj, na krijojnë përshtypjen e njerëzve të hekurt. Por ushtarakët janë njerëz si gjithë të tjerët, kanë ndjenja, dashuri dhe lidhje të forta emocionale. Prandaj, pavarësisht sfidave, shumë prej tyre gjejnë mënyra për të shprehur dashurinë dhe për të festuar ditët e veçanta në mënyrën e tyre. Ushtarakët shpesh janë të angazhuar në misione, në zona lufte ose në detyra të largëta, që i pengon të jenë pranë të dashurve të tyre në ditë romantike.

Në kulturën ushtarake, emocionet personale shpesh vendosen në plan të dytë për shkak të përkushtimit ndaj detyrës dhe disiplinës.

Ushtarakët shpesh perceptohen si njerëz të përmbytur dhe të fokusuar në misionin e tyre, prandaj ideja e tyre duke festuar një ditë romantike mund t’i befasojë disa.

Për të na treguar më shumë për dashurinë, këtë ndjenjë sublime, sakrificat në rrugëtimin e tyre të përbashkët për gazetën “Ushtria”, kapiten Marjana Kotarja dhe nënkolonel Alban Kurti, sjellin një pjesë të jetës bashkëshortore.

Faleminderit që pranuat të flisni me ne sot! Si një ushtarak, si e përjetoni Ditën e të Dashuruarve, sidomos kur jeni larg familjes?

Nënkolonel Albani: Përsëritet dhe faleminderit për mundësinë që na jepni, që nëpërmjet shtypit ushtarak, të shprehim dhe ndjenjat tona, për ata që janë suportuesit tanë në këtë rrugëtim të vështirë, nën uniformën ushtarake. Të qenit ushtarak është një profesion që kërkon shumë përkushtim dhe shpesh na ndan nga të dashurit tanë, veçanërisht në raste të veçanta si ky. Megjithatë, kjo ditë mbetet e rëndësishme, pasi më kujton sa e vlefshme është dashuria dhe sa shumë rëndësi ka për të mbajtur lidhjet e forta, edhe në distancë.

Si ia dilni të mbani gjallë romancën, kur jeni larg për shkak të detyrës?

Nënkolonel Albani: Teknologjia na ndihmon shumë në këtë aspekt. Komunikojmë përmes mesazheve, video-thirrjeve apo edhe letrave kur është e mundur. Gjithashtu, përpiqemi që, sa herë që jemi bashkë, ta bëjmë kohën sa më cilësore. Më ka ndodhur që të dërgoj dhurata surprizë nga larg, për t’i treguar partneres sime se, edhe pse fizikisht nuk jam aty, ajo është gjithmonë në mendjen dhe zemrën time.

A mendoni se të qenit ushtarak ndikon në mënyrën si e shprehni dashurinë?

Nënkolonel Albani: Patjetër. Të qenit në një profesion si ky më ka mësuar të vlerësoj më shumë momentet me të dashurit e mi dhe të jem më i ndërgjegjshëm për kohën që kalojmë së bashku. Kur ke pak mundësi për të qenë pranë personave të zemrës, çdo moment bëhet më i çmuar dhe dashurinë e shpreh ndoshta më thellë, jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime të vogla që kanë shumë domethënie.

A keni ndonjë mesazh për ata që kanë partnerë ushtarakë dhe e ndiejnë mungesën e tyre në Ditën e të Dashuruarve?

Nënkolonel Albani: E kuptoj shumë mirë se sa e vështirë është të ndash jetën me dikë që është shpesh larg për shkak të detyrës. Por do t’u thosha që dashuria nuk matet me kilometrat. Mbështetja, mirëkuptimi dhe besimi janë baza për ta bërë lidhjen e fortë. Dhe më besoni, edhe ne ushtarakët e ndiejmë po aq mallin dhe dashurinë për ata që kemi larg.

Si jeni njohur ju me partneren tuaj?

Nënkolonel Albani: Ah, është një histori e veçantë për ne! Jemi njohur krejt rastësisht. Unë isha në një periudhë trajnimi dhe kisha një fundjavë të lirë. Një mik më ftoi në një kafene dhe



Nënkolonel Alban Kurti



Kapiten Marjana Kotarja

● Të qenit ushtarak është një profesion që kërkon shumë përkushtim dhe shpesh na ndan nga të dashurit tanë, veçanërisht në raste të veçanta si ky. Megjithatë, kjo ditë mbetet e rëndësishme, pasi më kujton sa e vlefshme është dashuria dhe sa shumë rëndësi ka për të mbajtur lidhjet e forta, edhe në distancë.

aty ishte edhe ajo, (bashkudhëtarja e jetës sime) me disa shoqe. Fillimisht bëmë një bisedë të thjeshtë, por kishte diçka tek ajo që më tërhoqi menjëherë, thjeshtësia dhe buzëqeshja e saj.

Kush e bëri hapin e parë?

Nënkolonel Albani: Duhet ta pranoj që isha unë! Më pëlqeu energjia e saj dhe guxova t’i kërkoj numrin. Ajo qeshi dhe më tha: “Ushtarakët qenkan të vendosur, apo jo?” (qesh). Kështu filluam të flasim më shpesh dhe kuptuam se kishim shumë gjëra të përbashkëta.

Çfarë ndodhi më pas?

● E kuptoj shumë mirë se sa e vështirë është të ndash jetën me dikë që është shpesh larg për shkak të detyrës. Por do t’u thosha që dashuria nuk matet me kilometrat. Mbështetja, mirëkuptimi dhe besimi janë baza për ta bërë lidhjen e fortë.

Nënkolonel Albani: Fillimisht nuk ishte e lehtë, sepse shërbimi më kërkonte të largohesha shpesh. Por ajo më kuptoi dhe më mbështeti në çdo hap. Kjo më bëri ta dua edhe më shumë. Çdo herë që kthehesha, ishte si një fillim i ri për ne. Tani, sa herë që jemi bashkë, e vlerësojmë çdo moment.

Faleminderit që ndatë këtë histori me ne! Urojmë që dashuria juaj të mbetet gjithmonë e fortë!

Nënkolonel Albani: Faleminderit juve! Dashuria është forca më e madhe, qoftë në distancë apo afër!



Jeta në një familje ushtarake me siguri ka sfidat dhe bukuritë e saj. Si është të bashkëjetosh me dikë që është pjesë e ushtrisë?

Kapiten Marjana: Është një përvojë unike, me shumë emocione dhe sfida. Nga njëra anë, ndiej krenari të madhe për partnerin tim dhe sakrificat që bën për vendin. Nga ana tjetër, ka momente të vështira, sidomos kur ai duhet të largohet për periudha të gjata. Nuk është e lehtë të menaxhosh mungesën, por me kohën mësohesh dhe gjen mënyra për ta bërë lidhjen të funksionojë.

Si ndikon disiplina ushtarake në jetën e përditshme familjare?

Kapiten Marjana: (Qesh) Oh, ndikon shumë! Ata janë shumë të organizuar, çdo gjë ka vendin e vet dhe respektojnë një rutinë strikte. Ndonjëherë më duket sikur edhe në shtëpi funksionojmë sipas një "regjimi" të vogël ushtarak! Por kjo ka edhe anën pozitive, shumë përgjegjësi dhe përkushtim ndaj familjes. Për shembull, ai është gjithmonë i përpiktë, i përkushtuar dhe e merr seriozisht çdo detyrë, qoftë në ushtri apo në familje.

Po për fëmijët, si është të rriten në një familje ushtarake?

Kapiten Marjana: Fëmijët rriten duke parë një model disipline dhe përkushtimi. Nga njëra anë, ndonjëherë ndiejnë mungesën e babait ose nënës në raste të veçanta, por nga ana tjetër, mësojnë të jenë të pavarur, të fortë dhe të respektojnë vlerat e sakrificës dhe shërbimit. Ata e kuptojnë që prindi i tyre ka një mision dhe kjo i bën krenarë.

Si e kaloni kohën kur jeni të gjithë bashkë?

Kapiten Marjana: Çdo moment bashkë është i shenjtë. Përpiqemi të kalojmë kohë cilësore, të bëjmë aktivitete familjare, të dalim në natyrë ose thjesht të shijojmë qetësinë e shtëpisë. Për ne, edhe momentet e vogla kanë shumë vlerë, sepse e dimë që ndonjëherë koha bashkë mund të jetë e kufizuar.

Cili është sekreti për ta mbajtur familjen të fortë, pavarësisht sfidave?

Kapiten Marjana: Besimi, komunikimi dhe durimi. Nuk është e lehtë të jetosh me dikë që mund të largohet në çdo moment për detyrë, por kur ka dashuri dhe mirëkuptim, çdo sfida mund të kalohet. Dhe mbi të gjitha, gjithmonë duhet të mbështesësh njëri-tjetrin, kjo është forca që e mban familjen të bashkuar.

Cili është mendimi i parë që ju vjen në mendje kur e shihni të veshur me uniformë?

Kapiten Marjana: Mendoj për gjithë rrugëtimin e tij, për sfidat dhe përkushtimin që kërkon kjo punë. Më kujtohet momenti i parë kur e pashë me uniformë dhe ndjeva një ndjenjë sigurie, si dhe një respekt të madh për të dhe për të gjithë ata që mbajnë atë uniformë me dinjitet.

Uniforma e ndryshon mënyrën si e shihni atë si person?

Kapiten Marjana: Në një farë mënyre, po. Kur është në rrobat e përditshme, është njeriu im i dashur, ai që qesh, bën shaka dhe ndan momentet më të bukura me mua. Kur është me uniformë, duket më serioz, më i përqendruar dhe më i fortë. Është sikur përfaqëson një ideal më të madh se vetja. Por pavarësisht uniformës, ai është i njëjti person që unë dua dhe admiroj çdo ditë.

A ka ndonjë moment të veçantë që ju ka mbetur në mendje kur e keni parë me uniformën e tij?

Kapiten Marjana: Po, një moment që nuk do ta harroj kurrë ishte dita kur u gradua. Kur e pashë me uniformën e re, të rregullt dhe plot krenari në sy, ndjeva një lumturi të madhe. Ishte një moment që më bëri të kuptoj sa shumë ka punuar dhe sakrifikuar për atë që është sot.

Sa e vështirë është të duash dikë që vesh këtë uniformë dhe që shpesh është larg për detyrë?

Kapiten Marjana: Nuk është e lehtë, por kur dashuria

● *Ndonjëherë më duket sikur edhe në shtëpi funksionojmë sipas një "regjimi" të vogël ushtarak! Por kjo ka edhe anën pozitive, shumë përgjegjësi dhe përkushtim ndaj familjes. Për shembull, ai është gjithmonë i përpiktë, i përkushtuar dhe e merr seriozisht çdo detyrë, qoftë në ushtri apo në familje.*

është e fortë, gjithçka bëhet e mundur. Ka net kur mungesa ndihet shumë, por më ngushëllon fakti që ai po bën diçka të rëndësishme. Dashuria dhe mirëkuptimi janë çelësi për ta përballuar këtë jetë.

Çfarë do t'i thoshit partnerit tuaj nëse do ta lexonte këtë tani?

Kapiten Marjana: Do t'i thosha: "Jam krenare për ty, për atë që përfaqëson dhe për forcën që ke. Edhe kur je larg, unë jam gjithmonë pranë teje. Të dua dhe do të pres gjithmonë me të njëjtën dashuri".

Faleminderit shumë për ndarjen e kësaj përvoje të veçantë! Ju urojmë shumë lumturi dhe forcë!

Kapiten Marjana: Faleminderit juve! Familjet e ushtarakëve janë si një skuadër, bashkë mund të përballojmë çdo sfida!

Të dua një ushtarak do të thotë të dua një hero të përditshëm!





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Nuk më vjen turp për veshjen, kaq mundësi kanë prindërit”

Një ngjarje e rëndë tronditi Gjirokastrën pak ditë më parë! Një 17-vjeçare i dha fund jetës për shkak të bullizmit të vazhdueshëm që e reja përjetonte nga shoqëria e saj në shkollë.

Në ditën që ajo kishte marrë vendimin për t’i dhënë fund jetës, vajza ishte larguar 3 herë nga shkolla dhe ishte nisur për në shtëpi, ku çdo herë brenda në banesë kishte qenë babai i saj. Ajo ka vrarë veten në dhomën e saj ndërsa pas ka lënë një letër ku shkruante se askush nuk e afron dhe se të gjithë e tallin për paraqitjen e saj.

“O Zot, përse po vuaj kështu vallë? Unë jam kjo që jam, dhe miqtë dhe shokët kërkoj të më respektojnë. Por ata tallen me mua. Unë ndihem kaq e vetmuar dhe e mbytur në vetminë time. Nuk më vjen turp për veshjen time. Kaq mundësi kanë prindërit e mi, babi im që kujdeset aq shumë për mua aq sa dhe mami. Po përse u dashkam të jem kaq e veçuar? Ku të ankohe? Kujt t’i drejtohem? Kujt t’ia hap zemrën time? Tek askush nuk kam besim. Madje as tek psikologia ndonëse jam hapur. Përse u dashka të vuaj? Vallë kjo është jeta?”, shkruante 17-vjeçarja.

{Vajza e ka shkruar këtë letër në anglisht dhe e kishte fshehur në kapakun e celularit të saj}

Realitet i dhimbshëm që zanafillën e ka tek keq prindërimi, mënyra sesi qasemi ndaj faktit

Këto fjalë janë jashtëzakonisht të dhimbshme dhe pasqyrojnë një vuajtje të thellë emocionale. Një 17-vjeçare që ndan ndjenja të tilla të vetmisë dhe përjashtimit social po përballet me një dhimbje të rëndë që nuk duhet të neglizhohet. Kjo tregon sesa i fuqishëm mund të jetë ndikimi i bullizmit dhe vështirësive ekonomike tek të rinjtë. Kur dikush ndihet i pashpresë dhe pa asnjë person të besuar, rreziku për mendime të errëta bëhet edhe më i madh.

Ne dimë si t’i veshim fëmijët por nuk dimë si t’i edukojmë ata

Fatkeqësisht, bullizmi është bërë një problem serioz në Shqipëri dhe në shumë vende të tjera, duke shkaktuar pasoja të rënda tek të rinjtë, përfshirë edhe humbjen e jetëve. Presioni shoqëror, standardet e pamundura që vendosen nga rrjetet sociale dhe mungesa e ndërgjegjësimit po krijojnë një ambient ku shumë të rinj ndihen të pa përfshirë, të turpëruar dhe të pashpresë.

Rritja e presionit social dhe material: Të rinjtë sot përballen me një botë, ku veshja, pasuria dhe statusi social janë bërë të rëndësishme për pranimin nga shoqëria.

Rrjetet sociale si armë bullizimi: Talljet dhe përqeshjet nuk ndodhin vetëm në shkollë, por vazhdojnë edhe online, duke e bërë të pamundur “shpëtimin” për viktimat.

Mungesa e ndërhyrjes nga të rriturit: Shumë prindër dhe mësues nuk e kuptojnë sa serioz është ky problem ose nuk dinë si ta trajtojnë.

Frika për të folur: Shumë fëmijë dhe të rinj nuk kërkojnë ndihmë nga frika se do të përçmohen edhe më shumë ose se askush nuk do t’i marrë seriozisht.

Bullizmi duhet të trajtohet si një problem serioz me masa konkrete, jo thjesht si “lojë mes fëmijësh”. Duhet të ketë psikologë të trajnuar që ndihmojnë fëmijët të përballojnë presionin dhe të kenë besim për të folur. Ndëshkime më të rrepta për bullistët. Ata që ushtrojnë bullizëm duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Fëmijët duhet të mësojnë se vlera e tyre nuk përcaktohet nga pasuria apo pamja e jashtme. Ata duhet të edukohen mbi këtë problem dhe të krijojnë një ambient të hapur ku fëmijët të ndihen të sigurt për të folur.

Kjo nuk është një çështje që mund të lihet në heshtje

Çdo jetë e humbur nga bullizmi është një dështim i shoqërisë sonë. Duhet të veprojmë tani, përpara se të jetë tepër vonë. Mbështetje nga njerëzit e afërt, edhe një bisedë e thjeshtë me dikë që dëgjon pa paragjykuar mund të bëjë ndryshim të madh. Mësuesit, psikologët dhe organizatat duhet të jenë më të vëmendshëm dhe të krijojnë një mjedis ku nxënësit ndihen të sigurt për të shprehur veten. Është e rëndësishme që të rinjtë të kuptojnë se vlera e tyre

Fjalët kanë fuqi magjike, përdori për të ndryshuar botën!

Mirësia është investimi më i bukur për të ardhmen e një shoqërie



nuk përcaktohet nga veshjet apo mendimi i të tjerëve. Nëse dikush ndjen që nuk mund ta përballojë këtë barrë i vetëm, ndihma nga një terapist i specializuar mund të bëjë një ndryshim të madh.

Nëse kjo histori është e dikujt, shikoje si të jetë e jotja, sepse e nesërmja mund të jetë zjarr i shuar i vatrës tënde. Është shumë e rëndësishme që të mos lihet në heshtje. Vetmia dhe dëshpërimi mund të jenë të rënda, por me ndihmën e duhur mund të kalohen.

Veshjet firmato dhe telefonat e shtrenjtë nuk janë të rëndësishme për jetën tonë në thelb, por fatkeqësisht, shoqëria moderne shpesh na bën të ndihemi të pafuqishëm përballë falsitetit luksoz, i cili shkatërroi balancat e jetës njerëzore.

Pse njerëzit i japin kaq shumë rëndësi gjërave materiale?

Sepse jemi përballë presionit shoqëror dhe kulturës së dukjes. Sepse shumë njerëz, veçanërisht të rinjtë, ndihen të detyruar të kenë veshje të shtrenjta dhe telefona të fundit për të qenë “të pranuar” nga të tjerët.

Sepse influenza e rrjeteve sociale, Instagrami, TikTok dhe mediat e tjera promovojnë një jetë “perfekte” me rroba të shtrenjta, makina luksoze dhe teknologji të fundit, duke krijuar një ndjenjë inferioriteti tek ata që nuk i kanë.

Sepse po ndodh lidhja e gabuar mes statusit dhe vlerës personale, njerëzit kanë filluar të besojnë se një markë e shtrenjtë i bën më të rëndësishëm ose më të suksesshëm në sytë e të tjerëve.

Çfarë është vërtet e rëndësishme në jetë?

Një telefon i shtrenjtë nuk mund të të bëjë të lumtur nëse nuk ndihesh mirë me veten. (Si ndiheni sot ju bashkëmoshatarët e kësaj luleje që po çelte bukur sikurse ju, por nuk ia dhatë mundësinë të shkëlqente ndjenjash, duke e sulmuar pa shkak?!)

A ndiheni të lumtur mes veshjeve të ngrohta firmato, kur trupi i shoqes tuaj të pa rritur mirë tretet nën dheun e zi?

A ia vlen të matim vlerën e njëri-tjetrit me marka dhe pasuri?

Jo, sepse pasuria nuk përcakton vlerën e një njeriu.

Jo, sepse lumturia nuk vjen nga rrobat e shtrenjta, por nga marrëdhëniet dhe mirëkuptimi me të tjerët.

Jo, sepse një shoqëri që lejon që fëmijët dhe të rinjtë të ndihen të pashpresë për shkak të mungesës së parave, është një shoqëri që ka dështuar.

Në vend që të jemi të fiksuar pas dukjes dhe materializmit, duhet të fokusohemi në mirësinë, ndihmën dhe ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, ku askush të mos ndihet i pavlerë, sepse nuk ka veshje të shtrenjta apo telefon të fundit.

Miqtë dhe familja e vërtetë nuk të duan për atë që ke, por për atë që je. Një mendje e hapur dhe e zhvilluar vlen shumë më tepër sesa një çantë firmato.

Kur e pranohet veten ashtu siç je, nuk ke nevojë për marka për

t’u ndjerë me vlerë.

Shoqëria jonë MUND të bëhet më e dhembshur dhe më e drejtë, por vetëm nëse ne zgjedhim të ndryshojmë

Duke edukuar veten dhe të tjerët, nëse kuptojmë se vlera e një njeriu nuk matet me veshjet dhe pasurinë, atëherë mund të ndalojmë bullizmin dhe diskriminimin.

Duke qenë më empatikë, në vend që të gjykojmë dikë për mënyrën si vishet apo çfarë telefoni ka, le të pyesim si ndihet dhe çfarë po përjeton.

Duke folur kundër padrejtësive, kur shohim bullizëm apo përjashtim shoqëror, të mos heshtim. Heshtja shpesh është bashkëpunim me padrejtësinë. Duke ndihmuar ata që kanë nevojë, nuk duhet të jemi të pasur për të ndihmuar. Një fjalë e mirë, një mbështetje morale apo një gjest i vogël mund të ndryshojë jetën e dikujt.

Duke ndryshuar mënyrën si rrisim fëmijët tanë, nëse mësojmë brezat e rinj që vlera nuk qëndron në dukje, por në karakter, atëherë kemi një shoqëri më të shëndetshme.

Nuk mund ta ndryshojmë botën menjëherë, por mund të ndryshojmë mënyrën si sillemi me njëri-tjetrin. Dhe kjo është pika ku nis ndryshimi!

Në vend që të gjykojmë, të krahasohemi apo të lëndojmë njëri-tjetrin, le të zgjedhim të duam, të mbështesim dhe të kuptojmë.

Çdo njeri po lufton një betejë të tijën, edhe nëse ajo nuk duket nga jashtë.

Ajo kurrë nuk fajësoi prindërit për kushtet ekonomike, ajo nuk u ndje kurrë keq se veshja e saj nuk ishte në nivelin tuaj. Ajo nuk urreu asnjëherë, ajo nuk foli keq për ata që i shkaktuan këtë dhimbje saqë jeta ju duk më e bukur në përjetësinë e saj. Ajo ju sheh nga lart me sytë ‘pa jetë’ dhe ju fal, sepse kështu janë engjëjt.

Ne jemi humanë dhe si të tillë kemi mundësi të ndryshojmë veten dhe botën, sepse e kemi ‘detyrë’

Dhe si ndodh kjo?! Duke qenë miq të vërtetë. Duke mos e lënë askënd vetëm në momentet e vështira. Një fjalë e ngrohtë mund të ndryshojë ditën (ose jetën) e dikujt.

Fjalët kanë fuqi magjike, përdori ato për të ndërtuar dhe jo për të shkatërruar. Ndhmo pa pritur asgjë në këmbim, mirësia është investimi më i bukur për një shoqëri më të drejtë dhe më të dashur.

Rritni vetëbesimin tek njëri-tjetri, tregoji shokut apo shoqes tënde se është i/e vlefshme ashtu siç është.

Një botë më e mirë nuk vjen nga qeveritë apo nga njerëzit e famshëm, ajo fillon nga ne, nga mënyra si sillemi me njëri-tjetrin çdo ditë.

Duajeni dhe mbështeteni njëri-tjetrin! Sepse bashkë mund të bëjmë një ndryshim të vërtetë!

Ministeriali i Mbrojtjes:

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s,

fokusohen në shpenzimet e mbrojtjes

dhe mbështetjen për Ukrainën

Ministrat e Mbrojtjes nga vendet e NATO-s përfunduan takimin e tyre në Bruksel, duke krijuar skenën për samitin e ardhshëm të NATO-s në Hagë në qershor. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mark Rutte nisi fjalën e tij duke shprehur dhe pikëllimin e tij për ngjarjen tragjike në Mynih. “Më lejoni të filloj duke shprehur tronditjen dhe pikëllimin tim për lajmet që vijnë nga Mynihu, ku shumë njerëz janë plagosur në atë që duket se ka qenë një sulm i qëllimshëm. Ne solidarizohemi me aleatin tonë Gjermaninë dhe mendimet tona janë me viktimat dhe të dashurit e tyre”.

Z. Rutte shprehu gjithashtu kënaqësinë e tij për mirëseardhjen e Sekretarit të ri të Mbrojtjes së SHBA-ve, Pete Hegseth, në takimin e tij të parë të NATO-s. “Sekretari Hegseth erdhi me një mesazh të qartë. Për angazhimin e qëndrueshëm të Amerikës për një Aleancë të fortë të NATO-s. Dhe për pritshmëritë e qarta të Amerikës që të gjithë aleatët të mbajnë pjesën e tyre të drejtë të barrës”.

Sekretari i ri i Mbrojtjes së SHBA-ve, Pete Hegseth u shpreh në fjalën e tij se “objektivat strategjikë të NATO-s janë të parandalojë konfliktin e fuqive të mëdha në Evropë, të pengojë agresionin bërthamor dhe jo-bërthamor dhe të mposhtë kërcënimet ndaj aleatëve të traktatit nëse frenimi dështon. SHBA-të janë të përkushtuara për të ndërtuar një NATO më të fortë, më vdekjeprurëse. Megjithatë, ne duhet të sigurojmë që angazhimi evropian dhe kanadez ndaj nenit tre të këtij traktati të jetë po aq i fortë”.

Ai tha gjithashtu se udhëheqësit e aleatëve evropianë duhet të marrin përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e kontinentit, duke pasur parasysh realitetet strategjike me të cilat përballemi. Ai shtoi se kjo fillon me rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes. Duke cituar presidentin Trump ai tha se shpenzimet e mbrojtjes duhet të jenë më shumë se 5 për qind “dhe ky është investim real dhe urgjencë e vërtetë”.

Nga ana tjetër ministrat diskutuan gjithashtu për përparimin që forcon parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s dhe planet e fuqishme të mbrojtjes për të cilat kanë rënë dakord të gjithë aleatët. “Për të siguruar që ne jemi plotësisht të gatshëm për të zbatuar këto plane, ne kemi nevojë për më shumë aftësi ushtarake dhe për këtë ne kemi nevojë për shumë më shumë shpenzime të mbrojtjes”, - theksoi zoti Rutte. “Është e qartë nga diskutimet tona sot se aleatët e njohin nevojën për të investuar shumë më tepër”, - shtoi ai.

“Kur bëhet fjalë për të mbajtur të fortë parandalimin dhe mbrojtjen tonë, ne miratuar planet e fuqishme të mbrojtjes të hartuara nga Komandanti Suprem i Aleatëve, Gjenerali Cavoli, për të mbrojtur një miliard njerëzit tanë. Për t’u siguruar që jemi plotësisht të gatshëm për t’i zbatuar këto plane edhe në të ardhmen, ne kemi nevojë për më shumë aftësi ushtarake dhe për këtë kemi nevojë për shumë më shumë shpenzime për mbrojtjen. Kështu që nuk ka kohë për të humbur. Liria dhe prosperiteti ynë i vazhdueshëm varen prej saj. Shpenzimet e mbrojtjes tashmë po rriten”.

Ai vuri në dukje se që nga viti 2014, aleatët evropianë dhe Kanada janë shtuar më shumë se 700 miliardë dollarë amerikanë në buxhetet e mbrojtjes. Vetëm në vitin 2024, investimet nga aleatët jo-SHBA arritën në 485 miliardë dollarë amerikanë, duke shënuar një rritje prej 20% nga viti i kaluar, me dy të tretat e aleatëve që tani shpenzojnë të paktën 2% të PBB-së për mbrojtje. Sekretari i Përgjithshëm parashikon rritje të mëtejshme në vitin 2025, duke pranuar progresin e bërë, por duke theksuar nevojën për përpjekje të vazhdueshme.

“Është e qartë nga diskutimet tona sot se aleatët e njohin nevojën për të investuar shumë më tepër. Disa njoftuan rritje të mëdha të shpenzimeve në takimin e sotëm. Dhe unë pres që shumë ministra të kthehen në shtëpi nga takimi i sotëm me një ndjenjë edhe më të madhe urgjence”.

Ministrat e mbrojtjes diskutuan gjithashtu për rritjen e bazës industriale të mbrojtjes në të dy anët e Atlantikut, duke njohur nevojën për një mentalitet të kohës së luftës për të siguruar parandalim dhe mbrojtje të besueshme përballë sfidave në rritje të sigurisë.

“Ne diskutuam gjithashtu nevojën për të rritur prodhimin e mbrojtjes ndërsa rritim shpenzimet e mbrojtjes. Industria jonë duhet të jetë në gjendje të prodhojë atë që paratë tona shtesë na lejojnë të prokurojmë. Ne kemi parë tashmë një rritje të konsiderueshme të prodhimit të mbrojtjes në të gjithë Aleancën vitet e fundit. Ne po prodhojmë më shumë dhe më shpejt se në çdo kohë në dekada. Por ne mund dhe duhet të bëjmë më shumë. Për të siguruar besueshmërinë e parandalimit dhe mbrojtjes sonë për vitet në vijim, ne duhet të kalojmë në një mentalitet të kohës së luftës. Dhe ne kemi nevojë që industria të zhvendoset me ne”.

Në samit aleatët ranë dakord për një plan veprimi të përditësuar



për të rindërtuar një industri të fortë të mbrojtjes në të dy anët e Atlantikut. “Një industri e fuqishme e mbrojtjes do ta bëjë Aleancën më të fortë dhe do të krijojë më shumë vende pune në Evropë dhe Amerikën e Veriut”, u shpreh Sekretari i Përgjithshëm Rutte.

Në seancën e Këshillit NATO-Ukrainë me Ministrin ukrainas të Mbrojtjes Rustem Umerov, aleatët diskutuan rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme për Ukrainën, “e cila është thelbësore në mënyrë që kjo luftë brutale agresioni të mund të marrë një fund të drejtë dhe të qëndrueshëm. Të gjithë aleatët dhe Ukraina janë të bashkuar në dëshirën e tyre për paqe në Ukrainë. Të gjithë jemi dakord se duhet ta vendosim Ukrainën në pozicionin më të mirë të mundshëm për negociatë. Dhe ne kemi nevojë për një paqe të qëndrueshme, jo një Minsk tre. Nuk mund të lejojmë që presidenti Putin të fitojë”, - deklaroi Sekretari i Përgjithshëm Rutte.

“Aleatët morën parasysh iniciativën e Presidentit Trump për bisedimet e paqes, të cilin Sekretari Hegseth e kishte përshkruar tashmë në konsultimet tona brenda UDCG dje pasdite. Ne diskutuam rëndësinë e mbështetjes sonë të vazhdueshme për Ukrainën. E cila është thelbësore në mënyrë që kjo luftë brutale agresioni të mund të marrë një fund të drejtë dhe afatgjatë. Aleatët diskutuan edhe nevojën që aleatët evropianë dhe Kanada të bëjnë edhe më shumë.

Në vitin 2024, aleatët e NATO-s dhanë mbi 50 miliardë euro ndihmë sigurie për Ukrainën – gati 60% e kësaj vjen nga Evropa dhe Kanada. Kjo është shumë mbi 40 miliardë që kishim premtuar për vitin.

Komanda e sapokrijuar e NATO-s në Wiesbaden, Gjermani, është në krye të koordinimit të këtyre kontributeve. Kjo komandë tashmë është funksionale dhe po bën punë të rëndësishme.

Aleatët gjithashtu njoftuan paketa të reja të mbështetjes ushtarake dy ditët e ministerialit. Sekretari i Përgjithshëm u shpreh se “kjo do ta ndihmojë Ukrainën në luftën e saj sot dhe për të ndërtuar forcat e armatosura të Ukrainës në planin afatgjatë. E gjithë kjo dërgon një sinjal të qartë se Evropa dhe Kanada po marrin një pjesë më të madhe të ndarjes së barrës transatlantike”.

Ndërsa NATO premtoi 40 miliardë euro për Ukrainën në vitin 2024 në Samitin e Uashingtonit, ndihma aktuale e sigurisë siguroi tejkalimin e pritjeve, duke arritur në mbi 50 miliardë euro, me gati 60% të asaj të siguruar nga Evropa dhe Kanada.

“E gjithë kjo dërgon një sinjal të qartë se Evropa dhe Kanada po marrin një pjesë më të madhe të ndarjes së barrës transatlantike”, - përfundoi zoti Rutte.

NATO publikon politikën për mbrojtjen e integruar ajrore dhe raketore
